

MONTESSORI ALBANIA SH.P.K.

Pasqyrat Financiare  
për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014

MONTESSORI ALBANIA SH.P.K.  
Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014  
*(Vlerat janë në Lek)*

---

PËRMBAJTJA:

	FAQE
PASQYRAT FINANCIARE:	
BILANCI KONTABËL	2
PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE	3
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	4
PASQYRA E FLUKSIT TË PARASË	5
SHËNIME TË PASQYRAVE FINANCIARE	6 - 17

MONTESSORI ALBANIA SH.P.K.  
Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014

(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e Pozicionit Financiar  
Më 31 Dhjetor 2014

AKTIVE	Shenime	Dhjetor 31, 2014	Dhjetor 31, 2013
Aktive afatshkurtra			
Paraja dhe ekuivalentët e saj	4	17,119,830	8,448,189
Llogari të arkëtueshme	5	17,623,728	7,876,451
Parapagime dhe shpenzime të shtyra	6	8,492,735	3,819,605
Inventari		-	404,890
Aktive të tjera afatshkurtra	7	4,062,147	135,145
<b>Total Aktiveve Afatshkurtra</b>		<b>47,298,440</b>	<b>20,684,280</b>
Aktivet afatgjata		-	-
Aktive afatgjata materiale	8	93,674,623	37,235,222
Llogari të tjera të arkëtueshme		-	-
<b>Total aktive afatgjata</b>		<b>93,674,623</b>	<b>37,235,222</b>
<b>Total Aktive</b>		<b>140,973,063</b>	<b>57,919,502</b>
DETYRIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Hua afatshkurtra	9	36,721,480	1,649,579
Llogari të pagueshme tregëtare	10	12,011,719	7,946,984
Te ardhura të shtyra	11	60,816,932	26,464,121
Llogari të pagueshme të tjera	12	4,250,783	7,032,795
<b>Total Detyrime afatshkurtra</b>		<b>113,800,914</b>	<b>43,093,479</b>
Detyrime afatgjata			
Hua afatgjata	13	24,715,930	23,772,063
Grante dhe të ardhura të tjera afatgjata	14	15,036,148	17,693,452
<b>Total Detyrime afatgjata</b>		<b>39,752,078</b>	<b>41,465,515</b>
<b>Totali i detyrimeve</b>		<b>153,552,992</b>	<b>84,558,994</b>
Kapitali aksionar			
Kapitali aksionar	15	100,000	100,000
Rezerva të tjera	15	5,729,967	7,209,754
Rezerva ligjore		-	-
Fitime të mbartura	15	(32,469,460)	(20,482,560)
Fitimi i ushtrimit	23	14,059,564	(13,466,686)
<b>Total kapitali aksionar</b>		<b>(12,579,929)</b>	<b>(26,639,492)</b>
<b>Totali i kapitalit dhe detyrimeve</b>		<b>140,973,063</b>	<b>57,919,502</b>

Bilanci kontabël duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 17, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Mirlinda Boshnjaku  
Administrator



Hartues i Pasqyrave Financiare

Blerita Hoxha



MONTESSORI ALBANIA SH.P.K.  
 Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014  
 (Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e Te ardhurave dhe Shpenzimeve  
 Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014


	Shenime	Dhjetor 31, 2014	Dhjetor 31, 2013
Te ardhura	16	133,959,757	83,701,652
Te ardhura te tjera		2,490,820	348,630
Materiale te para dhe te konsumueshme	17	(5,530,113)	(4,218,962)
Shpenzime personeli	18	(82,037,105)	(65,193,900)
Shpenzime zhlyerësimi dhe amortizimi	19	(6,381,670)	(4,747,738)
Shpenzime te tjera	20	(26,252,538)	(25,824,008)
<b>Fitimi operativ</b>		<b>16,249,151</b>	<b>(15,934,326)</b>
Te ardhurat te tjera nga granti	21	1,736,202	3,044,836
Te ardhura/(Shpenzime) financiare Neto	22	(2,397,774)	(577,196)
<b>Total shpenzime financiare</b>		<b>(661,572)</b>	<b>2,467,640</b>
<b>Fitimi para tatimit</b>		<b>15,587,579</b>	<b>(13,466,686)</b>
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	23	(1,528,015)	-
<b>Fitimi i vitit</b>		<b>14,059,564</b>	<b>(13,466,686)</b>

Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 17, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Mirlinda Boshnjaku  
 Administrator




Hartues i Pasqyrave Financiare



MONTESSORI ALBANIA SH.P.K.  
Pasqyrat Financiare për vitin e mbylltur më 31 dhjetor 2014

(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e Levizjeve të Kapitalit  
Për vitin e mbylltur më 31 Dhjetor 2014

	Kapitali aksionar	Teprica nga rivleresimi	Fitime / (Humbje) të akumuluar	Fitim (Humbje) Ushtrimit	Totali
01 Janar 2013	100,000	-	-	(20,482,560)	(20,382,560)
Transferim në fitime të mbartura	-	-	(20,482,560)	20,482,560	-
Fitimi i vitit	-	-	-	(13,466,686)	(13,466,686)
Rivleresim I AAM 31.12.2013		7,209,754			
31 Dhjetor 2013	100,000	7,209,754	(20,482,560)	(13,466,686)	(26,639,492)
Transferim I teprices nga rivleresimi I AAM		(1,479,787)	1,479,787	-	
Transferim në fitime të mbartura	-	-	(13,466,686)	13,466,686	-
Fitimi i vitit	-	-	-	14,059,566	14,059,566
31 Dhjetor 2014	100,000	5,729,967	(32,469,460)	14,059,566	(12,579,927)

Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 17, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbylltur më 31 dhjetor 2014 u aprovuan nga Administratori Shoqërisë Montessori Albania sh.p.k. dhe u nënshkruan si më poshtë më 30 Mars 2015 nga:

Mirlinda Boshnjaku  
Administrator



Hartues i Pasqyrave Financiare

*Blerida Hoxha*

MONTESSORI ALBANIA SH.P.K.  
Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014

(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e Fluksit të Parasë  
Më 31 Dhjetor 2014

PASQYRA E FLUKSIT TE PARAVE	Shenime	Dhjetor 31, 2014	Dhjetor 31, 2013
<b>Flukset e parasë nga aktivitetet operative</b>			
Fitimi para tatimit		15,587,579	(13,466,687)
Axhustime për zërat jo-monetare:			
Zhvlerësimi dhe amortizimi		6,381,670	4,747,738
Shpenzime për interesa		1,790,878	599,760
Diferenca konvertimi		(606,896)	(22,564)
Tatimi mbi fitimin			
<i>Ndryshimi ne kapitalin qarkullues</i>		-	
Ndryshimi ne llogari te arketueshme dhe te tjera		(13,067,384)	(6,811,036)
Ndryshim ne tepricen e inventarit		404,890	(404,890)
Ndryshimi ne llogari te pagueshme dhe te tjera		814,708	18,548,170
Ndryshimi ne parapagime e shpenzime te shtyra		(4,673,130)	(1,853,971)
Ndryshimi ne detyrime te tjera		31,695,507	18,345,113
Mjetet monetare te gjeneruara nga aktivitetet operative		38,327,822	19,681,633
Interesa te paguara		(1,790,878)	(599,760)
Tatimi mbi fitimin i paguar gjate vitit		(1,060,000)	
		(2,850,878)	(599,760)
<b>Aktivitetet investuese</b>			
Blerje te aktiveve afatgjata material		(62,821,071)	(13,846,640)
Shitje e aktiveve afatgjata material		-	-
Interesa te marra		-	-
Mjete monetare te gjeneruara nga aktiviteti investues		(62,821,071)	(13,846,640)
<b>Aktivitetet financuese</b>			
Te ardhura nga emetimi i kapitalit aksioner		-	-
(Ripagim)/ te hyrat neto nga huate agjatgjata		1,015,768	-
(Ripagim)/ te hyra nga hua afatshkurter		35,000,000	-
Shtesa/pakesime ne qera financiare		-	-
Dividendë paguar		-	-
Mjete monetare te gjeneruara nga aktiviteti financues		36,015,768	-
Ndryshimi neto i mjeteve monetare		8,671,641	5,235,233
Mjetet monetare ne fillim te periudhës		8,448,189	3,212,958
Mjetet monetare ne fund te periudhës	4	17,119,830	8,448,190

Pasqyra e fluksit të parasë duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 17, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Mirinda Boshnjaku  
Administrator




Hartues i Pasqyrave Financiare

Blerida Memaj  
Duf

MONTESSORI ALBANIA SH.P.K.  
Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014

(Vlerat janë në Lek)

1. TË PËRGJITHSHME

Shoqëria "Montessori Albania" Sh.p.k. është themeluar si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar ne Regjistrin e Shoqërive date 11.12.2007, ne perputhje me Ligjin nr. 9901, date 14.04.2008 "Mbi Shoqërite tregtare".

Objekti i shoqërisë është arsimit parashkollor, shkolla jopublike 9-vjecare dhe e mesme, organizim kursesh të ndryshme.

Administratori i shoqërisë është : Znj.Mirlinda Boshnjaku.

Zyra qendrore e shoqërisë ndodhet ne Rruga Medar Shtylla, Selite e Vogel, prane Kompleksit Dinamo, Tirane.

NIPTI i shoqërisë është : K72411007G.

Më 31 dhjetor 2014 Shoqëria kishte 65 punonjes. (2013 : 52 punonjes).

2. BAZAT E PËRGATITJES

2.1 Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me legjislacionin kontabel dhe tatimor ne Shqipëri. Pasqyrat Financiare janë përgatitur ne perputhje me Ligjin Nr. 9228 date 29 Prill 2004 « Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare » dhe Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK 2).

2.2 Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.4 Vijueshmeria

Pasqyrat financiare paraqiten sipas parimit te vijueshmerise, qe do te thote se veprimtaria ekonomike e shoqërisë do te kete vijueshmeri dhe se nuk ka ne plan ose nuk do ta kete te nevojshme ta nderprese aktivitetin e saj.

2.5 Vlerësime dhe gjykime

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon nga drejtuesit të ushtrjnë gjykimin e tyre në procesin e zbatimit të politikave kontabel të shoqërisë dhe shumave të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund të ndryshojë nga këto vlerësime.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabel janë të njohura në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar si dhe në periudhat e ardhshme që preken.

Në veçanti, informacion mbi fushat më të rëndësishme të vlerësimeve dhe gjykimeve në aplikimin e politikave kontabel të cilat kanë efektet më të rëndësishme në shumat e njohura në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimet përkatëse të pasqyrave financiare. Përdorimi i vlerësimeve kontabel është minimal në këto pasqyra financiare duke patur parasysht thjeshtësinë e veprimeve të realizuara nga Shoqëria.

3. POLITIKAT KONTABEL

Politikat kontabel të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është



### 3.POLITIKAT KONTABËL (VAZHDIM)

diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2014 dhe 2013 është detajuar si më poshtë:

	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013
Kurset e këmbimit		
Euro/Lek	140.14	140.20
Usd/Lek	115.23	101.86

#### 3.2 Instrumenta financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbje, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

##### *Mjetet monetare*

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

##### *Llogari të arkëtueshme*

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provigjioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provigjionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

##### *Llogari të pagueshme*


Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

##### *Hua të marra dhe të dhëna*

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve.

##### *Vlera e drejtë*

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.





### 3.POLITIKAT KONTABËL (VAZHDIM)

#### *Të tjera*

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

#### *Kapitali aksionar*

Kapitali aksionar njihet me vlerën nominale. Aksionet e zakonshme klasifikohen si kapitale.

### 3.3 Aktivët Afatgjatë materiale

#### *i. Njohja dhe matja*

Të gjitha aktivët afatgjatë materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivit afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjatë materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

#### *ii. Kostot e mëpasshme*

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjatë materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afat-gjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

#### *iii. Amortizimi*

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivët e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit.


Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin aktual është si më poshtë:

Aktive	Përqindja
Toka	0%
Ndertesë	5%
Mjete Transporti	20%
Mobilje dhe Pajisje zyre	20%
Pajisje Informatike	25%
Te tejsira AQT	25%

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi.

#### *iv. Rivlerësimi*

Kur rivlerësohen AAM-te, amortizimi i akumuluar në datën e rivlerësimit eliminohet kundrejt vlerës kontabel bruto të aktivit dhe vlera neto rideklarohet në shumën e rivlerësuar të aktivit ose rivlerësohen dhe vlera historike dhe amortizimi i akumuluar. Shuma e rregullimit që vjen nga rideklarimi ose eliminimi i amortizimit të akumuluar kontabilizohet në "tepricë nga rivlerësimi" nëse vlera kontabel e AAM-se rritet dhe shumën e rivlerësimit njihet si e ardhur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.



### 3.POLITIKAT KONTABËL (VAZHDIM)

Teprica nga rivlerësimi e përfshire në kapitalet e veta për një element të AAM-se, duhet të kalohet në fitimet e pashpendara për gjatë jetës së dobishme të aktivitetit afatgjatë material. Teprica e transferuar çdo vit është diferenca midis amortizimit të llogaritur mbi bazën e vlerës kontabel të rivlerësuar të aktivitetit dhe amortizimit të llogaritur bazuar mbi koston fillestare të aktivitetit. Ky transferim nuk behet nepermjet pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve.

#### 3.4 Aktivet financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohen të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferenca midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

#### 3.5 Provigjonet

Një provigjion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provigjionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë.

#### 3.6 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat nga shërbimet e ofruara njihen në pasqyrën e të ardhurave në varësi të fazës së përfundimit të transaksionit në datën e bilancit. Asnjë e ardhur nuk njihet nëse ka pasiguri të lartë lidhur me kryerjen e pagesës dhe kostove përkatëse.

#### 3.7 Të ardhura dhe shpenzime financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

#### 3.8 Tatimi mbi fitimin

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin përfshin tatimin e vitit, i cili njihet drejtpërdrejt në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Tatimi i vitit është tatimi i pritshëm për t'u paguar mbi të ardhurat e tatueshme të vitit, duke përdorur normat tatimore të miratuara gjatë vitit.



MONTESSORI ALBANIA SH.P.K.  
Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014  
(Vlerat janë në Lek)

4. MJETE MONETARE

Teprica e likujditeteve per vitin qe mbyllet me 31 Dhjetor 2014 dhe ate qe mbyllet me 31 Dhjetor 2013 paraqitet si më poshtë:

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
	ne Lek	ne Lek
Vlera monetare ne leke	6,254,639	402,263
Arka	19,252	34,619
Banka	6,235,387	367,644
Vlera monetare ne valute	10,865,191	8,045,926
Arka	925,892	7,874,564
Banka	9,939,299	171,362
<b>Totali</b>	<b>17,119,830</b>	<b>8,448,189</b>

5. LLOGARI TË ARKËTUESHME

Llogaritë e arkëtueshme përfaqësojnë detyrime të pa arkëtuara nga klientët në datën e mbylljes se Pasqyrave Financiare.

Llogaritë e arkëtueshme më 31 dhjetor 2014 dhe 2013 janë si më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2014	Më 31 dhjetor 2013
Klientë për shërbime	17,623,728	7,876,451
<b>Totali</b>	<b>17,623,728</b>	<b>7,876,451</b>

6. PARAPAGIME DHE SHPENZIME TE SHTYRA

Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra më 31 dhjetor 2014 dhe 2013 janë si më poshtë:

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
	ne Lek	ne Lek
Pagapagime te dhena	1,575,119	685,558
Shpenzime te periudhave te ardhshme	6,917,616	3,134,047
<b>Totali</b>	<b>8,492,735</b>	<b>3,819,605</b>

7. LLOGARI TË TJERA TË ARKËTUESHME

Në llogaritë tjera të arkëtueshme janë paraqitur të tjera të drejta per tu arketuar si me poshte:

	Më 31 dhjetor 2014	Më 31 dhjetor 2013
Keste Taksa Bashkie Biznes i Vogël	78,000	78,000
Tatim fitimi i parapaguar	-	57,145
Kerkesa te tjera per arketim	3,984,147	-
<b>Totali</b>	<b>4,062,147</b>	<b>135,145</b>



MONTESSORI ALBANIA SH.P.K.  
Pasqyrat Financiare për vitin e mbylltur më 31 dhjetor 2014  
(Vlerat janë në Lek)

8. AKTIVE AFATGJATA MATERIALE

	Toka	Ndertesa	Mobilje e Orendi	Mjete Transporti	Pajisje kompjuterike	Pajisje elektronike	Te tjera	Licenca e software	Totali
<i>Kosto</i>									
Gjendja më 31 Dhjetor 2012	-	-	5,101,312	9,123,095	3,939,385	5,131,950	-	-	23,295,742
Shtesa	-	10,500,000	160,527	2,455,075	691,038	-	40,000	-	13,846,640
Rivleresim AAM 31.12.2013	-	-	4,371,677	(2,478,170)	255,837	(2,050,850)	-	-	98,494
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Gjendja më 31 Dhjetor 2013	-	10,500,000	9,633,516	9,100,000	4,886,260	3,081,100	40,000	-	37,240,876
Shtesa	60,013,072	-	1,256,844	-	991,526	341,994	49,635	168,000	62,821,071
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Gjendja më 31 Dhjetor 2014	60,013,072	10,500,000	10,890,360	9,100,000	5,877,786	3,423,094	89,635	168,000	100,061,947
<i>Amortizimi i akumuluar</i>									
Gjendja më 31 Dhjetor 2012	-	-	489,401	859,167	584,409	436,200	-	-	2,369,177
Amortizimi i vitit	-	131,250	932,689	1,816,457	1,080,849	785,160	1,333	-	4,747,738
Kthim amortizimi	-	(131,250)	(1,417,628)	(2,675,624)	(1,665,258)	(1,221,360)	-	-	(7,111,120)
Gjendja më 31 Dhjetor 2013	-	-	4,462	-	-	-	1,333	-	5,795
Amortizimi i vitit	-	525,000	2,037,932	1,820,000	1,330,486	638,320	10,682	19,250	6,381,669
Gjendja më 31 Dhjetor 2014	-	525,000	2,042,394	1,820,000	1,330,486	638,320	12,015	19,250	6,387,464
<i>Vlera neto kontabël</i>									
Gjendja më 31 Dhjetor 2012	-	-	4,611,911	8,263,928	3,354,976	4,695,750	-	-	20,926,565
Gjendja më 31 Dhjetor 2013	-	10,500,000	9,629,054	9,100,000	4,886,401	3,081,100	38,667	-	37,235,222
Gjendja më 31 Dhjetor 2014	60,013,072	9,975,000	8,848,107	7,280,000	4,547,300	2,784,775	77,620	148,750	93,674,623



MONTESSORI ALBANIA SH.P.K.  
Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014

(Vlerat janë në Lek)

9. HUAMARRJE AFATSHKURTER

Në këtë zë janë paraqitur huatë afatshkurtra më 31 dhjetor 2014 dhe 2013:

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
	ne Lek	ne Lek
Huamarrje Afatshkurter Leasing	1,721,480	1,649,579
Huamarrje te tjera Afatshkurter	35,000,000	-
<b>Totali</b>	<b>36,721,480</b>	<b>1,649,579</b>

10. LLOGARI TË PAGUESHME TREGTARE

Në këtë zë janë paraqitur detyrimet e palikujduara ndaj furnitorëve më 31 dhjetor 2014 dhe 2013:

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
	ne Lek	ne Lek
Furnitore	12,011,719	7,946,984
<b>Totali</b>	<b>12,011,719</b>	<b>7,946,984</b>

11. TE ARDHURA TE SHTYRA

Te ardhurat e shtyra per vitin 2014 dhe vitin 2013 paraqiten si me poshte:

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
	ne Lek	ne Lek
Te ardhura te shtyra	60,816,932	26,464,121
<b>Totali</b>	<b>60,816,932</b>	<b>26,464,121</b>

12. LLOGARI TE PAGUESHME TE TJERA

Detyrimet te tjera më 31 dhjetor 2014 dhe 2013 paraqiten si më poshtë:

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
	ne Lek	ne Lek
Te pagueshme ndaj punonjesve	800,195	178,935
Sigurime Shendetsores & Shoqerore	1,309,456	850,237
Tatim mbi te ardhurat personale( TAP)	1,289,944	529,518
Tatim ne burim	123,399	92,890
Tatim mbi fitimin	410,870	-
TVSH per tu paguar	81,957	27,751
Te pagueshme te tjera	234,963	5,353,464
<b>Totali</b>	<b>4,250,783</b>	<b>7,032,795</b>



MONTESSORI ALBANIA SH.P.K.  
Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014

(Vlerat janë në Lek)

13. HUA AFATGJATA

Huate afatgjata per vitin 2014 dhe 2013 paraqiten si me poshte:

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
	ne Lek	ne Lek
Huamarrje Afatgjata	24,715,930	23,772,063
<b>Totali</b>	<b>24,715,930</b>	<b>23,772,063</b>

14. GRANTE DHE TË ARDHURA TË TJERA AFATGJATA

Ne kete ze jane paraqitur grantet dhe te ardhura te tjera afatgjata për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014 dhe 2013 janë si më poshtë:

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
	ne Lek	ne Lek
Grante dhe te ardhura te tjera afatgjata	15,036,148	17,693,452
<b>Totali</b>	<b>15,036,148</b>	<b>17,693,452</b>

15. KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i Shoqërisë është në vlerë 100,000 Leke.

Teprice nga rivleresimi

Teprica nga rivleresimi perfaqeson rezerva nga rivlersimi i AAM-ve në shumen 5,729,967 Leke.

Kjo shume eshte zvogeluar ne krahasim me vitin 2013 ne vleren 1,479,787 leke e cila perfaqeson diferencen midis amortizimit nga rivleresimi me amortizimin me kosto historike te AAM-ve.

Fitime te pashperndara

Fitimet e pashperndara paraqiten ne vleren (32,469,460) leke, e cila eshte rritur per te njejten vlere me pakesimin e zerit Teprica nga rivleresimi.


Fitimi i ushtrimit

Shuma prej 14,059,566 leke perfaqeson fitimin neto te vitit te mbyllur më 31 Dhjetor 2014.

16. TË ARDHURAT

Të ardhurat nga veprimtaria e zakonshme për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014 dhe 2013 janë si më poshtë:

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
	ne Lek	ne Lek
Te ardhura nga aktiviteti	133,959,757	83,701,652
Te ardhurat te tjera shfrytezimi	2,490,820	348,630
<b>Totali</b>	<b>136,450,577</b>	<b>84,050,282</b>



MONTESSORI ALBANIA SH.P.K.  
Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014

(Vlerat janë në Lek)

16. TË ARDHURAT (VAZHDIM)

Të ardhurat nga veprimtaria e zakonshme për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014 janë në vlerën prej 136,450,577 leke. Të ardhura të deklaruara në sistemin elektronik të tatimeve gjatë vitit 2014 janë në vlerën 172,150,663 leke. Ndryshimi prej 35,190,906 leke shpjegohet si me poshte:

	Dhjetor 31, 2014
Rakordimi i te ardhurave me FDP-ne	
Qarkullim i tatueshem	172,150,663
Zbriten Autofaturimet 2014	(945,914)
Paradhenie per efekt neto	(34,754,172)
Shuma e qarkullimit e korrektuar	136,450,577
Sipas Kontabilitetit	136,450,577
Diferenca	-

17. MATERIALE TE PARA DHE TE KONSUMUESHME

Kosto e materialeve të konsumuara ushqimore për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014 dhe 2013 paraqitet si me poshte:

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
	ne Lek	ne Lek
Materiale te konsumuara ushqimore	5,530,113	4,034,573
Kosto e mallrave te shitur	-	184,389
<b>Totali</b>	<b>5,530,113</b>	<b>4,218,962</b>

18. SHPENZIMET E PERSONELIT


Shpenzimet per pagat e personelit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014 sipas deklarimit ne sistemin elektronik te tatimeve jane ne vleren 75,111,302 leke, diferenca per 155,256 leke perfaqeson pagat e deklaruara por te papaguara te personelit.

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
	ne Lek	ne Lek
Pagat e personelit	74,956,046	60,335,835
Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	7,081,059	4,858,065
<b>Totali</b>	<b>82,037,105</b>	<b>65,193,900</b>

19. SHPENZIME ZHVLERËSIMI DHE AMORTIZIMI

Ne kete ze paraqitet shuma e amortizimit te aktiveve afatgjata materiale te llogaritura sipas normave fiskale ne fuqi.

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
	ne Lek	ne Lek
Shpenzime amortizimi	6,381,670	4,747,738
<b>Totali</b>	<b>6,381,670</b>	<b>4,747,738</b>



MONTESSORI ALBANIA SH.P.K.  
Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014

(Vlerat janë në Lek)

20. SHPENZIME TË TJERA

Ne kete ze jane paraqitur shpenzimet e tjera me 31 Dhjetor 2014 dhe 2013:

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
	ne Lek	ne Lek
Shpenzime konsulence perkthimi,noterizime	817,718	471,207
Energji/uje/telefon/internet	3,748,121	2,148,090
Karburant, qera dhe te tjera	6,877,280	10,386,396
Mirembajtje riparime	609,412	873,481
Siguracione	248,300	285,911
Sherbim roje, pastrimi	2,089,851	2,307,194
Shpenzime trajnimi	2,237,817	2,933,382
Sherbim transporti	9,912	446,434
Kancelari, literature	3,454,454	2,005,164
Komisione bankare	409,483	330,728
Taksa dhe tarifa vendore	105,710	36,520
Te tjera	5,644,480	3,599,501
<b>Totali</b>	<b>26,252,538</b>	<b>25,824,008</b>

21. TË ARDHURA DHE SHPENZIME TË TJERA FINANCIARE

Te ardhurat dhe shpenzimet financiare jane analizuar si me poshte:

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
	ne Lek	ne Lek
Shpenzime nga interesat	(1,790,878)	(599,760)
Humbje nga kembimet valutore	(771,001)	(334,815)
Te ardhura nga kembimet valutore	164,107	357,379
<b>Totali</b>	<b>(2,397,774)</b>	<b>(577,196)</b>

22. TË ARDHURA NGA GRANTI

Te ardhurat nga granti jane si me poshte:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013
Te ardhura nga granti	1,736,202	3,044,836
<b>Totali</b>	<b>1,736,202</b>	<b>3,044,836</b>





MONTESSORI ALBANIA SH.P.K.

Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014

(Vlerat janë në Lek)

23. TATIMI MBI FITIMIN

Shoqëria është subjekt i tatimit mbi të ardhurat në Shqipëri, norma e të cilit është 15% (2013: 10%). Formularët e deklarimit të tatimit mbi të ardhurat paraqiten çdo vit pranë autoriteteve tatimore, por të ardhurat dhe shpenzimet të deklaruarra për qëllime të tatueshme konsiderohen vetë deklarime deri në momentin që janë vëzhguar dhe vlerësuar nga autoritetet tatimore.

Legjislacioni tatimor dhe ligjet Shqiptare janë subjekt interpretimi nga autoritetet tatimore.

	Më 31 dhjetor 2014	Më 31 dhjetor 2013
Fitim i vitit përpara tatimit	15,587,579	(13,466,687)
Shpenzime të pazbritshme	3,485,585	3,246,555
Humbje e mbartur	(8,886,407)	(13,407,707)
Fitimi fiskal para tatimit	10,186,757	(23,627,839)
Tatimi mbi fitimin	1,528,015	-
Fitim/ Humbje Neto	14,059,564	(13,466,687)
	Per vitin e mbyllur me Dhjetor 31,2014	Per vitin e mbyllur me Dhjetor 31,2013
Tatim fitimi i parapaguar 1 Janar 2014	57,145	57,145
Tatim fitimi i parapaguar 2014 /2013	1,060,000	-
Tatim fitimi i vitit 2014/2013	(1,528,015)	-
Tatim fitimi per t'u paguar	(410,870)	57,145

24. TRANSAKSIONE ME PALË TË LIDHURA

Shoqëria nuk paraqet transaksione me pale të lidhura për vitin 2014.

25. ANGAZHIME DHE PASIGURI

*Çeshtje gjyqesore*

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Me 31 Dhjetor 2014 Shoqëria nuk ka asnjë çeshtje gjyqesore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kërkojë rregullime të ketyre pasqyrave financiare.

*Detyrimet tatimore*

Librat e Shoqërisë nuk janë audituar nga organet tatimore për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në mënyrë të besueshme.


26. NGJARJE PAS DATËS SË BILANCIT

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.

Mirinda Boshnjaku  
Administrator




Hartues i Pasqyrave Financiare



Tirane me, 31 Mars 2015

### VERTETIM

Me ane te kesaj shkrese vertetojme se MAZARS sh.p.k eshte angazhuar per te kryer auditimin e pasqyrave financiare te shoqerise **Montessori Albania shpk** me NIPT K72411007G dhe seli te regjistruar ne adresen: Rr. "Medar Shtylla", Selite e Vogel, prane Kompleksit Dinamo, Tirane, per vitin ushtrimor te mbyllur me 31 Dhjetor 2014.

Ne nuk e kemi perfunduar ende procesin e auditimit dhe ne kete moment nuk jemi ne gjendje te leshojme raportin e auditimit.

E leshojme kete vertetim, sipas kerkeses se shoqerise **Montessori Albania shpk**.

MAZARS sh.p.k  
Shoqeri Ekspertesh Kontabel te Regjistruar



Teit Gjini  
Administrator

 MAZARS

Rr. Emin Dureku, Pall. "Binjaket",  
No.5, 1000, Tirana, Albania  
phone: +355 42 27 80 15  
[www.mazars.al](http://www.mazars.al), [info@mazars.al](mailto:info@mazars.al)

Mazars shpk  
Rr. Emin Dureku - Pall. "Binjaket" N°5 - Tirana, Albania  
Tel/fax: +355 42 278 015 - [info@mazars.al](mailto:info@mazars.al) - [www.mazars.al](http://www.mazars.al)



**Praxity**  
GLOBAL ALLIANCE OF  
INDEPENDENT FIRMS